



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

**PLANI DHE PROGRAMI I PUNËS SË GJYKATËS
SUPREME**

(Janar - Dhjetor 2024)

Janar, 2024

FJALA E KRYETARIT

Në dritën e përkushtimit tonë të palëkundur për një sistem gjyqësor të drejtë dhe barabartë për të gjithë qytetarët, hapim një kapitull të ri në rrugën tonë drejt një Gjykate Supreme më efikase dhe transparente. Me synimin e rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të gjykatave në vendin tonë, do të përqendrohemi në avancimin e komunikimit me publikun përmes bashkëpunimit aktiv me mediat. Përmes krijimit të lidhjes me publikut, synojnë që qytetarëve t'ua mundësojmë marrjen e informacioneve të nevojshme me qëllimin për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me funksionimin e sistemit gjyqësor. Kjo iniciativë ka si qëllim forcimin e besimit të qytetarëve në drejtësi.

Në përputhje me këto synime, kemi planifikuar organizimin e një konference të rëndësishme, me krerët e drejtësisë së Evropës Qendrore dhe Lindore, ku Gjykata Supreme e Kosovës do të marrë një rol udhëheqës. Kjo ngjarje do të përfshijë një spektër të gjerë çështjesh, duke filluar nga përmirësimi i efikasitetit deri te sfidat dhe mundësitë në gjyqësor.

Pjesë e kësaj nisme do të jetë prezantimi i një dokumentari të veçantë të përgatitur nga Gjykata Supreme e Kosovës, duke shpjeguar historinë dhe rolin e saj në zhvillimin e drejtësisë në vend. Në rrugën drejt përmirësimit të efikasitetit, kemi bërë përparime të dukshme dhe mbetemi të përkushtuar për vazhdimësi në këtë udhëtim drejt suksesit. Po ashtu, në fushën e politikës ndëshkimore, synojmë unifikimin e politikave në nivel kombëtar dhe publikimin e buletineve mbi praktikën gjyqësore.

Gjatë kësaj periudhe, bashkëpunimi me institucionet relevante, përfshirë Ambasadën Amerikane në Kosovë, do të forcohet për të avancuar politikën ndëshkimore dhe përmirësuar sistemin gjyqësor. Synimi ynë përfundimtar është të rrisim besimin e qytetarëve në drejtësi dhe të përmirësojmë funksionimin e Gjykatës Supreme në Kosovë. Si kryetar, shpreh vendosmërinë time për të kryer këtë detyrë me përgjegjësi dhe ndërgjegje ndaj rolit kyç të gjyqësorit në vendosjen e drejtësisë, funksionimin e shtetit ligjor dhe demokracisë në shtetin tonë.

Fejzullah Rexhepi

Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

Përmbajtja e Planit dhe Programit të Punës

FJALA E KRYETARIT	2
1. Organizimi i punës në Gjykatën Supreme	4
1.1 Funkcionet gjyqësore dhe udhëheqja e degëve të Gjykatës.....	4
1.3 Përbërja e Kolegjeve	6
1.4 Ndarja e lëndëve	6
1.5 Orari vjetor i punës së Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme.....	7
2. Seancat e përgjithshme të Gjykatës Supreme	11
3. Orari i Punës dhe Respektimi i Kodit të Mirësjelljes	12
4. Zbatimi i programit TIK/SMIL.....	12
5. Fillimi i implementimit të sistemit të dosjes elektronike të gjyqtarëve.....	12
6. Transparenca dhe llogaridhënia	13
7. Administrata Gjyqësore	13
8. Komisioni Konsultativ për Politikë Ndëshkimore	13
9. Organizimi i Konferencës së Krerëve të Drejtësisë së Evropës Qendrore dhe Lindore 60- vjetori i Themelimit të Gjykatës Supreme	14
10. Bashkëpunimi me institucionet tjera.....	15
Përfundimi.....	15

1. Organizimi i punës në Gjykatën Supreme

Me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës udhëheqë kryetari i gjykatës, Fejzullah Rexhepi. Në mungesë të kryetarit me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës do të udhëheq nënkryetarja Mejreme Memaj. Me organizimin e punës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme udhëheq – u.d. gjyqtari mbikëqyrës Sahit Sylejmani.

Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimin e objektit, merret ushtruesja e detyrës së administratores Vjollca Cenaj, ndërsa për DHPGJS-në, administratori Isuf Behluli.

1.1 Funkcionet gjyqësore dhe udhëheqja e degëve të Gjykatës

Gjykata Supreme shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegji me nga tre (3) gjyqtarë profesionist, me përjashtim kur me ligj parashihet një numër më i madh i gjyqtarëve.

Në kuadër të Gjykatës Supreme funksionojnë degët gjyqësore:


Dega penale,

Dega civile,

Dega administrative, si dhe

Praktika gjyqësore,

Aktualisht, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës në përbërje të vet ka 16 gjyqtarë, përfshirë kryetarin, të cilët do të punojnë në kuadër të degëve si vijon:



Në Degën penale, udhëheqëse caktohet gjyqtarja Mejreme Memaj, zëvendës, gjyqtari Agim Maliqi.


•Gjyqtarja Valdete Daka caktohet për përcjelljen e praktikës gjyqësore në çështjet penale, ndërsa zëvendës caktohet gjyqtari Agim Maliqi.

Në Degën Civile do të punojnë këta gjyqtarë:



- Gjyqtari Rustem Thaqi caktohet udhëheqës i degës civile-komerciale, ndërsa zëvendës, Beshir Islami.
- Gjyqtari Rustem Thaqi caktohet për përcjelljen e praktikës gjyqësore në çështjet civile dhe komerciale, ndërsa zëvendës caktohet gjyqtari Muhamet Rexha. Deri në Pensionim praktiken e përcjell gjyqtari Shukri Sylejmani.

Në Degën administrative do të punojnë:



Në degën administrative janë të caktuar gjyqtarët Nebojsa Boricic dhe Ragip Namani si bartës të lëndëve, ndërsa anëtar të kolegjit do të jenë edhe gjyqtarët tjerë të degës civile sipas përzgjedhjes së SMIL-it, ndërsa në lëndët pa SMIL anëtare do të jetë gjyqtari Zenel Leku. Në rast të zgjedhjeve të jashtëzakonshme në vend, ankesat e pranuar nga palët ndaj vendimeve të PZAP-së, do t’ju ndahen të gjithë gjyqtarëve të degës civile, shkak i afateve të shkurta ligjore për trajtimin e tyre.

Për degën administrative, udhëheqës caktohet gjyqtari Nebojsa Boricic, ndërsa zëvendës gjyqtari, Ragip Namani.

Në Kolegjin e Apelit të Gjykatës Supreme do të punojnë:

- Beshir Islami
- Ragip Namani
- Nenad Lazic
- Ankesat në shkallë të tretë i kryeson kryetari apo nën kryetarja e Gjykatës.

Udhëheqësit e degëve do t'i raportojnë kryetarit të gjykatës për punën e degëve gjyqësore, së paku njëherë në tre (3) muaj. Pjesë e raporteve të udhëheqësve, duhet të jenë edhe raportet e gjyqtarëve përgjegjës të degëve.

1.3 Përbërja e Kolegjeve

Të gjitha çështjet në Degën Penale të Gjykatës Supreme gjykohen nga trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarësh profesional, nga të cilët njëri duhet të jetë kryetar i trupit gjykues.

Të gjitha çështjet në Degën Civile gjykohen nga tre (3) gjyqtarë, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe. Kolegje prej tre gjyqtarësh parashihen edhe për degën administrative dhe për lëndët në Kolegjin e Apelit.

Në çështjet ku palë janë të miturit, udhëheq gjyqtari Afrim Shala.

Plani dhe orari vjetor i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nuk është përfshirë në këtë material.

1.4 Ndarja e lëndëve

Lëndët në Gjykatë Supreme ndahen në mënyrë elektronike përmes Sistemit për Menaxhimin e Lëndëve – SMIL. Nëse gjyqtarit, të cilit i është caktuar lënda duhet përjashtuar nga arsyet e ndryshme, kërkesa për përjashtim duhet të bëhet tek kryetari. Në rastet kur paraqitet nevoja e ndryshimit të kolegjit të paracaktuar me SMIL, kërkesa bëhet tek kryetari për të gjitha ndryshimet e kolegjit, dhe ndryshim bëhet përmes sistemit SMIL.

1.5 Orari vjetor i punës së Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme

Kryetari i Gjykatës Supreme Fejzullah Rexhepi, në bazë të Ligjit për Gjykatat e Rregullta të Kosovës neni 25 par 7 , cakton orarin vjetor të punës së gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, për periudhën 01.01.2024 deri 31.12.2024. **Ky orar vlen në rastet kur kolegji i çështjeve, nuk është paracaktuar me SMIL.**

DEGA PENALE

Kolegji i parë në çështje penale me mjete të jashtëzakonshme juridike.

1. Valdete Daka, kryetare,

2. Rasim Rasimi, anëtar dhe

3. Mejreme Memaj, anëtare.

Kolegji i dytë në çështje penale me mjete të jashtëzakonshme juridike.

1. Mejreme Memaj, kryetare,

2. Agim Maliqi, anëtar

3. Afrim Shala, anëtar

Kolegji i parë për paraburgime Kolegji i parë është kujdestar në muajin tek

1. Agim Maliqi, kryetar

2. Valdete Daka, anëtare

3. Rasim Rasimi, anëtar.

Kolegji i dytë për paraburgime Kolegji i dytë është kujdestar në muajt çift

1. Valdete Daka, kryetare,

2. Afrim Shala, anëtar

3. Mejreme Memaj anëtare.

KOLEGJI PËR TË MITUR

1. Afrim Shala, kryetar

2. Rasim Rasimi, anëtar

3. Mejreme Memaj, anëtare

Anëtarët e kolegjit rezervë për kolegjin e të treve në lëmin penale

1. Java e I-rë Muhamet Rexha,

2. Java e II-të Beshir Islami,

3. Java e III-të Zenel Leku,

4. Java e IV-të Milena Djeric

5. Java e V-të Nebojsa Boricic,

6. Java e VI -të Rrustem Thaçi,

Dega civile

Anëtarët e Kolegjit të parë

1. Muhamet Rexha, kryetar

2. Zenel Leku, anëtar

3. Nenad Lazić , anëtar

Anëtarët e kolegjit të dytë

1. Beshir Islami, kryetar
2. Rrustem Thaqi, anëtar
3. Milena Djeric, anëtare

Përcaktimi i ndarjes së punës për gjyqtarët e çështjeve civile në rastet e përjashtimit

1. Rrustem Thaqi - Zenel Leku,
2. Milena Djeric – Beshir Islami,
3. Muhamet Rexha – Nenad Lazic

DEGA ADMINISTRATIVE

Kolegji i parë

Kolegji i parë është kujdestar në muajin tek

1. Nebojsa Boricic, kryetar,
2. Ragip Namani, anëtar
3. Zenel Leku, anëtar.

Kolegji i dytë

Kolegji i dytë është kujdestar në muajt çift

1. Ragip Namani, kryetar
2. Nebojsa Boriqiq, anëtar
3. Rrustem Thaqi, anëtar

Në kolegji vendosen të gjitha lëndët sipas mjeteve juridike të jashtëzakonshme dhe lëndët tjera administrative nëse me këtë orar nuk është përcaktuar që të vendosen në kolegji të veçantë. Eventualisht nëse Kryetari i kolegjit në çështje administrative përjashtohet për shkaqe procedurale, i njëjti zëvendësohet nga gjyqtari Beshir Islami.

Kolegji për vendosjen në shkallë të tretë (neni 26 par.1.3 të Ligjit për Gjykatat)

Kolegji i parë

1. Mejreme Memaj, kryetare (neni 26 par 1. gjykata Supreme vendos në shkallë të tretë për ankesat e lejuara me ligj;)

2. Afrim Shala, anëtar dhe

3. Rasim Rasimi, anëtar

Kolegji i dytë

1. Mejreme Memaj, kryetare

2. Valdete Daka, anëtare dhe

3. Agim Maliqi, anëtar.

*Në mungesë të kryetarit të kolegjit, gjyqtari Afrim Shala zëvendëson kryetarin. Lëndët në kolegji vendosen në përputhje me mjete juridike të jashtëzakonshme, ndërsa lëndët penale të tjera vendosen në kolegji të veçantë vetëm nëse kjo nuk është përcaktuar me orarin e punës. Kryetari i Gjykatës do të përcaktojë një orar të veçantë sipas nevojës për të plotësuar kolegjet për çdo rast konkret.

Në rast përjashtimi të gjyqtarit nga çështja penale, lënda i ndahet në punë gjyqtarit sipas kësaj radhitjeje:

1.Valdete Daka – Afrim Shala,

2. Rasim Rasimi – Agim Maliqi

3. Mejreme Memaj – Agim Maliqi

*Nëse ndonjëri nga gjyqtarët mungon nga kolegji penal për ndonjë arsye, atë e zëvendëson gjyqtari nga kolegji penal tjetër me radhitje të njëjte (p.sh. anëtarin e 3 (tretë) që mungon, e zëvendëson anëtari i 3 (tretë) i kolegjit tjetër e kështu me radhë.

Gjyqtarët e ngarkuar me unifikimin e praktikës gjyqësore, janë të ngarkuar me gjysmën e normës. Me rastin e ndarjes së lëndëve gjyqtarët në fjalë nuk ngarkohen me lëndë me radhë si gjithë gjyqtarët tjerë, por nëse ngarkohen një herë në rastin tjetër të radhës së ndarjes së lëndëve nuk përfshihen me gjyqtarët tjerë.

Ky orar i punës do të aplikohet prej datës së aprovimit në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme.

1.6 Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

Ky plan nuk përfshin mënyrën e organizimit të punës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, pasi UD- i Mbikëqyrësi është i obliguar të bëjë plan të veçantë.

2. Seancat e përgjithshme të Gjykatës Supreme

Kryetari i gjykatës thërret seancat e përgjithshme me qëllim të adresimit të kërkesave për mendime juridike, qëndrime parimore dhe udhëzime të nevojshme për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe zgjidhjen e dilemave në zbatimin e ligjit. Seanca vjetore e gjyqtarëve, organizuar në fillim të vitit nga kryetari i gjykatës, shërben për analizën e punës së vitit të kaluar, vlerësimin e funksionimit të gjykatës, hartimin e planit vjetor të punës për vitin e ardhshëm dhe diskutimin e çështjeve të tjera të propozuara nga kryetari i gjykatës në bashkëpunim me gjyqtarët.

Pjesëmarrja në këto seanca është e detyrueshme dhe rendi i ditës përcaktohet nga kryetari i gjykatës. Stafi i kabinetit të kryetarit, ndihmon në organizimin dhe zhvillimin e seancave të përgjithshme, duke njoftuar gjyqtarët së paku shtatëdhjetë e dy (72) orë para seancës dhe furnizon ata me materialet e rëndësishme për mbledhjen. Administratorja e gjykatës kujdeset për ruajtjen e procesverbalit dhe dokumentacionit për zhvillimin e mbledhjes, duke e dorëzuar paraprakisht ato te gjyqtarët për vërejtje. Më pas, procesverbalit i jepet miratimi në seancën tjetër dhe të gjitha dokumentet arkivohen në dosje të veçanta.

Kryetari i Gjykatës mund të thërret mbledhje të gjyqtarëve ose stafit për të diskutuar çështje të administrimit të gjykatës, organizimin e punës, arritjet dhe për të adresuar sfidat dhe problemet e punës.

3. Orari i Punës dhe Respektimi i Kodit të Mirësjelljes

Orari i punës në gjykatë fillon në ora 08:00 dhe zgjatë deri në ora 16:00, ndërsa pushimi ditor shfrytëzohet nga ora 12:00 deri në ora 13:00, në rast pamundësie të shfrytëzimit të pushimit brenda këtij orari, pushimi ditor mund të shfrytëzohet edhe jashtë këtij orari, por vetëm për të njëjtën ditë.

Gjyqtarët dhe personeli i kabinetit të Kryetarit janë të obliguar që për mungesën e tyre në zyre në Gjykatë, gjatë orarit të punës ta njoftojnë Kryetarin e Gjykatës, ndërsa stafi administrativ i gjykatës duhet ta njoftojnë ud. administratoren e Gjykatës Supreme.

Të gjithë të punësuarit në Gjykatën Supreme janë të obliguar që gjatë orarit të punës në ushtrimin e pozitës zyrtare, të sillen në mënyrë korrekte, duke respektuar Kodin e Mirësjelljes për Personelin e Administratës Gjyqësore, njëkohësisht Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë.

Veshja dhe paraqitja e të gjithë zyrtarëve të gjykatës, duhet të jenë serioze, për ta përfaqësuar sa më denjësisht institucionin në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Përdorimi apo aktivitetet e zyrtareve të gjykatës, përfshirë gjyqtarët në rrjetet sociale duhet të jenë të përgjegjshme dhe të paraqiten në mënyrë korrekte, ndërsa vendosja e fotografive dhe postimeve të ndryshme, duhet të jetë e kujdesshme në nivelin e paraqitjeve korrekte.

4. Zbatimi i programit TIK/SMIL

Në Gjykatën Supreme implementohet Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (TIK/SMIL). Me mbështetjen e zyrtarëve të teknologjisë informative të Gjykatës Supreme të gjitha lëndët ngarkohen në këtë sistem dhe raportet e të gjithë gjyqtarëve të nxjerrën vetëm përmes sistemit SMIL, përfshirë këtu edhe raportet e përgjithshme të gjykatës.

5. Fillimi i implementimit të sistemit të dosjes elektronike të gjyqtarëve

Në vitin 2024 do të fillojë implementimi i sistemi i dosjes elektronike të gjyqtarëve, i cili do të përbëhet prej pesë (5) moduleve, moduli i disiplinës së gjyqtarëve, i personelit, administrimit, trajnimeve, performancës.

Ky sistem modern do të lehtësojë shkëmbimin e informacionit, përmirësojë efikasitetin dhe rrisë transparencën në administratën gjyqësore.

Sistemi i dosjes elektronike do të ndihmojë në rritjen e transparencës, përmirësimin e efikasitetit dhe lehtësimin e qasjes të përdoruesve të autorizuar në informacionin relevante. Ky inovacion, do të kontribuojë në përmirësimin e administratës gjyqësore dhe sigurimin e një sistemi të përshtatshëm për nevojat e gjithë shoqërisë.

6. Transparenca dhe llogaridhënia

Gjykata Supreme, në vazhdimësinë e angazhimit të saj për transparencë dhe llogaridhënie, ka ndërmarrë disa masa që synojnë të sigurojnë informimin e përditshëm të qytetarëve në lidhje me punën dhe aktivitetet e saj. Ueb-faqja zyrtare dhe llogaria në Facebook janë burimet kryesore ku gjykata ndan informacionin e rrethuar nga puna dhe vendimet e saj. Publikimi i komunikatave të gjykatës rreth punës dhe aktiviteteve të saj, publikimi i aktgjykimeve dhe aktvendimeve, mendimeve juridike, udhëzimeve dhe dokumenteve tjera me rendësi të gjykatës relevante të gjykatës, janë pjesë e përpjekjeve për të siguruar qasje të hapur dhe të plotë për publikun. Kështu, duke kontribuar në krijimin e një mjedisi më transparent dhe llogaridhënës për të gjithë qytetarët.

7. Administrata Gjyqësore

Me menaxhimin e punëve administrative, teknike dhe sigurimit të objekteve, do të administrojë ud. administratorja e Gjykatës Supreme, Vjollca Cenaj, të cilën e zëvendëson në rast mungese Antigona Uka-Lutfiu.

Ud. administratorja menaxhon dhe mbikëqyrë funksionet administrative të gjykatës në mënyrë autonome, në bashkëpunim me kryetarin e gjykatës dhe në koordinim me Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

8. Komisioni Konsultativ për Politikë Ndëshkimore

Komisioni këshillëdhënës për politikë ndëshkimore, i formuar në gusht të vitit 2018, mision të veçantë ka zhvillimin dhe monitorimin e politikës ndëshkimore në vend.

Ky komision gjatë vitit 2024 do të vazhdojë aktivitetet dhe angazhimin në unifikimin e politikës ndëshkimore, me përkrahje nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë dhe UNDP.

Gjatë vitit 2024, pritet të finalizohet revidimi i Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore, i cili do të jetë me risi, ndryshe nga ai i vitit 2018, ndryshimet e këtij të fundit kanë për qëllim që me zbatimin e këtij udhëzuesit, respektivisht legjislacionit në fuqi, të bëhet unifikimi i politikës ndëshkimore.

Gjatë vitit 2024, Komisioni do të funksionoj në përbërjen si në vijim:

1. Fejzullah Rexhepi, Kryetar i Gjykatës Supreme - Kryesues i Komisionit
2. Agron Qalaj, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit – anëtar,
3. Agim Maliqi, Gjyqtar në Gjykatën Supreme – anëtar,
4. Bashkim Hyseni, Gjykata e Apelit – anëtar,
5. Albina Shabani Rama, Kryetare e Gjykatës Themelore Prishtinë – anëtare,
6. Enver Fejzullahu, Drejtor i Akademisë së Drejtësisë – anëtar,
7. Behar Ejupi, Kryetar i Odës së Avokatëve - anëtar.

Komisioni, gjatë punës së tij këtë vit, mund të shërbehet edhe me të dhënat, analizat, rekomandimet e grupeve punuese të degëve të gjykatës, të krijuara për këtë qëllim – politikën ndëshkimore.

Komisionin në punën e tij do ta ndihmojnë edhe gjyqtarët tjerë të Gjykatës Supreme, me dhënien e komenteve dhe sugjerimeve lidhur me udhëzuesin.

9. Organizimi i Konferencës së Krerëve të Drejtësisë së Evropës Qendrore dhe Lindore 60-vjetori i Themelimit të Gjykatës Supreme

Supreme Gjykata Supreme e Kosovës në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës si dhe me organizatën CEELI, do të organizojë konferencën e radhës së krerëve të drejtësisë së Evropës Qendrore dhe Lindore, njëkohësisht me këtë organizim do të kremtohet dhe gjashtëdhjetë vjetori i themelimit të Gjykatës Supreme të Kosovës. Me rastin e këtij organizimi do të realizohet një dokumentar i Gjykatës Supreme të Kosovës si dhe do të publikohet një broshurë e cila do të përmbajë historikun e Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe kontributin e saj në ndërtimin e sistemit të drejtësisë në vend. Konferenca do të sjellë në vëmendje sfidat dhe arritjet e drejtësisë në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore.

Programi i konferencës do të përfshijë prezantime nga krerët e drejtësisë nga vendet e ndryshme. Diskutimet do të adresojnë çështje thelbësore si pavarësia e gjyqësorit, sundimi i ligjit, lufta kundër korrupsionit si dhe të arriturat dhe sfidat e tjera të drejtësisë në këtë kontekst.

Në pjesën tjetër të eventit, do të transmetohet dokumentari i Gjykatës Supreme të Kosovës, i cili do të përcjellë historinë dhe zhvillimin e kësaj gjykate në kohën e saj ekzistencës. Gjithashtu, do të prezantohet broshura që do të mbërthejë momente kyçe dhe kontributet e Gjykatës Supreme në shërbim të drejtësisë dhe sundimit të ligjit në Kosovë.

Kjo konferencë është një mundësi unike për shkëmbimin e përvojave dhe njohurive midis krerëve të drejtësisë nga rajoni i Evropës Qendrore dhe Lindore, duke theksuar bashkëpunimin dhe solidaritetin në ndërtimin e një sistemi të fortë të drejtësisë.

10. Bashkëpunimi me institucionet tjera

Gjykata Supreme e Kosovës gjatë vitit 2024, do të vazhdojë bashkëpunimin e saj të mirëfilltë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese dhe Policinë e Kosovës. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi me Ambasadën Amerikane në Prishtinë dhe organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare si USAID, UNDP, CHEMONICS, OSBE, ROLAG, IKD, BIRN, GLSP, CLARD etj., vazhdon të jetë i rëndësishëm për Gjykatën Supreme.

Në këtë kontekst, Gjykata Supreme planifikon të zhvillojë takime, vizita në Gjykata, konferenca dhe aktivitete të tjera me qëllim të përmirësimit të sundimit të ligjit në vend, shqyrtimit të çështjeve gjyqësore dhe politikës ndëshkimore, si dhe ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor.

Gjatë këtij viti, Gjykata Supreme ka në plan të zhvillojë projektin i cili ka të bëjë me anketat e perceptimeve dhe përvojave rajonale të drejtësisë, në bashkëpunim me Bankën Botërore. Anketa e cila do të realizohet do të përfshijë gjyqtarë, administratën, qytetarë, si dhe të gjitha institucionet e drejtësisë, për të ofruar një pasqyrë të punës të sistemit të drejtësisë, duke bërë një vlerësim të detajuar dhe të përmbledhur të sistemit të drejtësisë dhe për të identifikuar fushat ku ka nevojë për përmirësim. Ky bashkëpunim me Bankën Botërore do t'i kontribuojë besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Gjykata Supreme do të vazhdojë të bëjë analiza të rregullta të praktikës së saj dhe të publikojë buletine të praktikës gjyqësore për të ndarë përvojën dhe të kontribuojë në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së vendimeve gjyqësore.

Përfundimi

Gjykata Supreme ka gëzuar mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Kosovë për analizimin e politikës ndëshkimore dhe hartimin e udhëzimeve për këtë çështje. Kjo bashkëpunim do të vazhdojë edhe në vitin 2024, duke përfshirë një partneritet të ngushtë me Komisionin Konsultativ për Politikë Ndëshkimore, nën udhëheqjen e kryetarit të Gjykatës Supreme.

Gjykata Supreme shpreh përkushtimin e saj ndaj sundimit të ligjit, drejtësisë dhe sigurisë juridike në vend, duke e bërë sistemin gjyqësor në Kosovë më të fortë, më të besueshëm dhe më të përshtatur me standardet ndërkombëtare.

Me qëllim të përmirësimit të sundimit të ligjit në vend, shqyrtimit të çështjeve gjyqësore dhe politikës ndëshkimore, si dhe ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor, Gjykata Supreme planifikon të zhvillojë takime, konferenca dhe aktivitete të tjera gjatë këtij viti. Së bashku me këto përpjekje, Gjykata Supreme ka planifikuar organizimin e një konference të rëndësishme, ku do të prezantojë dhe diskutojë çështje kyçe në fushën e drejtësisë. Kjo konferencë do të ofrojë një platformë të rëndësishme për shkëmbimin e ideve dhe përvojave, duke kontribuar në rrugën e përmirësimit të sistemit gjyqësor në Kosovë.

Për më shumë, në vitin 2024, do të fillojë implementimi i sistemit elektronik të dosjeve të gjyqtarëve, që përfshin pesë (5) module të ndryshme. Ky projekt teknologjik do të mundësojë një administrim më efikas të informacionit.

Gjykata Supreme, përmes iniciativave të ndërmarra, siguron një qasje të hapur dhe transparente për qytetarët, duke ndarë informacionin e rëndësishëm rreth punës së saj përmes ueb-faqes zyrtare dhe platformave sociale.

Ky plan i punës dhe programi për zgjidhjen efikase të lëndëve, zbatohet nga **01.01.2024**.

Obligohet Zyra për Informim, të publikoj këtë plan/program në ueb faqen e gjykatës.

Fejzullah Rexhepi

Datë: 23.01.2024

Kryetar i Gjykatës Supreme

Me këtë plan do të njoftohet:

Këshilli Gjyqësor i Kosovës